



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Informatë për mendimin e dërguar pranë MPB-së lidhur me propozimin Procedura standarde operative për veprime me persona të cilëve u është kufizuar e drejta për lëvizje të lire

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) konform kompetencave të cilat dalin nga Protokolli Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Rregullores për punën e Avokatit të Popullit, më datën 14.05.2014 sipas kërkesës së Ministrisë për Punë të Brendshme dërgoi Mendim sipas propozimit Procedura standarde operative për veprime me persona të cilëve u është kufizuar e drejta për lëvizje të lirë.

Në mendim u theksua se propozim Procedura standarde operative e cila është hartuar nga ana e ministrisë kompetente i përcakton standardet dhe procedurat e privimit nga liria dhe njëkohësishtë përfshin rekomandimet e Mekanizmit Parandalues Nacional.

Në mënyrë plotësuese u rekomandua që në Procedurën standarde operative për veprime me persona të cilëve u është kufizuar e drejta për lëvizje të lirë, të përfshihet edhe pjesa për ndalim konform Ligjit për kundërvajtje, përkatësisht të merret parasysh neni 96 i ligjit të përmendur ku qëndron se „Sipas kërkesës së personit të ndaluar për ndalimin do të njoftohet edhe punëdhënësi i tij, përkatësisht përfaqësia diplomatike e shtetit të huaj, nëse është e nevojshme të ndërmerret diçka për mbrojtjen ose përkujdesjen e fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, për të cilët kujdeset personi i ndaluar, si dhe qendra kompetente për punë sociale”.

Avokati i Popullit rekomandoi që Procedura standarde operative të plotësohet edhe me informimin e personit të ndaluar se është nën video-mbikëqyrje të vazhdueshme (në stacionet policore ku video-mbikëqyrja është në ambiente ku qëndrojnë persona të privuar nga liria), precizimin e afateve, më saktë, se „ Ndalimi mund të zgjasë deri 24 orë prej momentit të privimit nga liria dhe në këtë afat personi medoemos duhet të sillet para gjykatësit kompetent” të sigurohet e drejta për privatësi gjatë shfrytëzimit të toaletëve nga ana e personave të ndaluar, me përjashtim kur bëhet vlerësimi paraprak për rrezik dhe ekziston nevoja për mbrojtje të sigurisë personale, si të personit të ndaluar, ashtu edhe të sigurisë së zyrtarëve policor, thirrja e mjekut për qëllime parandaluese, në rast kur bëhet fjalë për shkallë të lartë të alkoolizmit të personit i cili është ndaluar në stacionin policor, si dhe propozime tjera në drejtim të

përmirësimin të rregullave operative me të cilat do të përforcohet sistemi i parandalimit dhe mbrojtjes nga veprimet johumane dhe brutale ndaj personave të cilët janë privuar nga liria.